

NDRYSHIME NË STATUTIN E SHOQËRISË ANONIME
"Shtëpia Botuese Enciklopedike"- Tiranë

Paragrafi i parë shfuqizohet dhe zëvendësohet me :

Hyrje

Mbështetur në nenin 128 të ligjit 7638 dt 19.11.1992 "Për shoqëritë tregëtare" Asambleja e Jashtëzakonshme e ShA "Shtëpia Botuese Enciklopedike" mbledhur më dt. 23.11.1996 vendosi të bëjë ndryshime në statutin e saj, të regjistruar në gjykatën e Tiranës me nr. vendim 14583, dt.10.04.1996. Ndryshimet e mëposhtme diktohen nga fakti i privatizimit 100% të aksioneve të ish Shoqërisë shtetërore anonime "Shtëpia Botuese Enciklopedike", privatizim që vërtetohet nga dokumentat bashkangjitur.

Neni 1: shfuqizohet dhe zëvendësohet me:

Neni 1

30. 01. 1997

Forma e shoqërisë

-Shoqëria anonime "Botimet Enciklopedike" është shoqëri anonime pa ofertë publike, me kapital 100% privat. Ajo është krijuar nga transformimi i ish shoqërisë shtetërore anonime "Shtëpia botuese Enciklopedike", nëpërmjet privatizimit me ankand dhe nga ndryshimi i emrit në "Botimet Enciklopedike"; Kohëzgjatja e saj do të jetë mbi 10 vjet.

Selia e shoqërisë do të jetë në qytetin e Tiranës, Rruga Muhamet Gjollësia.

Neni 2: shfuqizohet dhe zëvendësohet me:

Neni 2

Objekti i shoqërisë

1. Botim dhe tregëtim librash, revistash, kalendarësh, fletorësh, blloqesh, pllakatësh dhe gjithshkaje tjetër që shtypet mbi letër, karton ose materiale të tjera.

2. Tregëtim i materiale të kancelarisë që nuk futen në kategorinë e mësipërme, si lapsa, stilolapsa, bojra, mjete të ndryshme zyre, etj. Në përgjithësi gjithshka duhet si mjet pune për zyrat, shkollat dhe institucionet e tjera.

3. Tregëtim i pajisjeve të zyrave, si ordinatorë, fakse, fotokopjatriçe, tavolina pune, etj. Në përgjithësi gjithshka duhet për të pajisur një zyrë sipas kërkesave bashkëkohore.

4. Tregëtim të letres, kartonit dhe materialeve të tjera mbi të cilat mund të shtypet, në të gjitha llojet dhe format.

5. Tregëtim i instrumentave dhe pajisjeve të ndryshme për të gjitha fushat e artit (muzikës, arteve figurative, filmit, fotografisë, lojrave elektronike, programeve kompjuteristike, etj.). Në përputhje me ligjin mbi të drejtat e autorit realizon riprodhimin dhe tregëtimin e materialeve artistike si kaseta, videokaseta, videogames, riprodhime pikturë e skulpturë, filma, etj.

Neni 3: shfuqizohet dhe zëvendësohet me:

Neni 3

Kapitali themeltar- Aksionet

Kapitali themeltar i shoqërisë është 6. 000. 000 lekë. Ai është ndarë në 6000 aksione të së njëjtës kategori, të cilat zotërohen tërësisht nga 102 aksionerë, sipas listës së aksionerëve të depozituar. Vlera nominale e aksionit është 1000 lekë.

Neni 4 : shfuqizohet dhe zëvendësohet me:

Neni 4

Transferimi i aksioneve

1. Aksionet e shoqërisë mund t'u transferohen personave të tjerë fizikë e juridikë shqiptarë e të huaj me miratim të asamblesë ku përfaqësohet të paktën 1/2 e kapitalit, pasi të jenë lajmëruar sipas procedurës së duhur të gjithë aksionerët. Ky miratim presupozon që në radhë të parë oferta për blerje t'u bëhet aksionerëve të shoqërisë. Në rast se ata nuk dëshirojnë të blejnë me çmimin e ofruar, aksionet konsiderohen lirisht të transferueshme, por jo me çmim më të ulët nga ai që u është ofruar atyre. Vendimi merret me shumicën e votave.

2. Në rast vdekjeje të aksionerit, aksionet e tij trashëgohen sipas ligjit .Transferimi i tyre mund të bëhet nga këta të fundit pas regjistrimit si aksionerë në librin përkatës, duke ndjekur të njejtën procedurë si më lart.

3. Transferimi aksioneve jashtë procedurës së mësipërme konsiderohet i paligjshëm dhe nuk njihet nga shoqëria.

Neni 6 : shfuqizohet dhe zëvendësohet me:

30. 01. 1997

Neni 6
Këshilli mbikqyrës

I. Këshilli mbikqyrës përbëhet nga tre antarë, të cilët emërohen nga Asambleja e Jashtëzakonshme e shoqërisë.

II. Kohëzgjatja e funksionit të tyre është 2 vjet. Ata mund të shkarkohen nga detyra edhe brenda këtij afati, me kërkesë të aksionerëve që përfaqësojnë të paktën 1/4 e kapitalit themeltar. Miratimi për pezullimin e tyre merret në Asamblenë ku përfaqësohet të paktën 1/2 e kapitalit themeltar. Vendimi merret me shumicën e votave.

III. Antarët e keshillit mbikqyrës janë persona fizikë. Ata janë të rizgjedhshëm.

IV. Propozime për antarët e Keshillit Mbikqyrës ka të drejtë të bëjë çdo aksioner ose grup aksionerësh që përfaqëson të paktën 10% të kapitalit të shoqërisë.

V. Në rast fatkeqësie, shkarkimi ose dorëheqjeje, zëvendësimi i antarit të keshillit mbikqyrës bëhet sipas kërkesave të ligjit, nga një asambëlë ku të pranishmit të përfaqësojnë të paktën 1/2 e kapitalit themeltar dhe me shumicën e votave. Antari i zgjedhur në këto raste nuk ka afat të përcaktuar kohor, por përfundon mandatin e paraardhësit.

Neni 10 : shfuqizohet dhe zëvendësohet me:

Neni 10
Shpërblimi i antarëve të keshillit mbikqyrës

-Shpërblimi i antarëve të Keshillit Mbikqyrës caktohet nga Asambleja e aksionerëve ku përfaqësohet të paktën 1/2 e kapitalit, me shumicë votash. Ky shpërblim mund të ndryshojë sipas të ardhurave të shoqërisë, por gjithmonë duke respektuar procedurën e mësipërme.

Neni 11 shfuqizohet dhe zëvendësohet me:

Neni 11
Asambleja e Aksionerëve

1. Asambleja e aksionerëve mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme. **Asambleja e jashtëzakonshme**, në të cilën mund të marrin pjesë të gjithë aksionerët, thirret për hartimin e statutit apo për ndryshime të tij, për emërimin e antarëve të keshillit mbikqyrës e për çështje të tjera të caktuara me ligj dhe për të cilat nuk është vendosur shprehimisht në këtë statut. Ajo thirret nga keshilli mbikqyrës ose drejtori i shoqërisë, sipas procedurave të caktuara.

2. **Asambleja e jashtëzakonshme** zhvillohet nëse janë të pranishëm aksionerë që përfaqësojnë të paktën 1/2 e kapitalit themeltar dhe vendos në sencë të parë me të paktën 3/4 e votave. Në rast se kjo kuotë nuk arrihet, vendoset në një seancë të dytë me shumicë votash.

3. **Asambleja e zakonshme** merr vendime për të gjitha problemet e tjera që tejkalojnë kompetencat e keshillit mbikqyrës e të drejtorit. Ajo mund të zhvillohet nëse të pranishmit përfaqësojnë të paktën 1/2 e kapitalit themeltar dhe vendoset me shumicë votash. Meqënëse numri i aksionerëve është i madh, kurse pjesa dërmuese e kapitalit zotërohet nga pak vetë, në Asamblenë e zakonshme mund të marrin pjesë aksionerë ose grup aksionerësh që përfaqësojnë të paktën 1% të kapitalit themeltar, me përfaqësim të noterizuar paraprakisht.

4. **Asambleja e zakonshme** thirret të paktën një herë në vit, brenda gjashtëmuorit që pason mbylljen e vitit financiar, nga keshilli mbikqyrës ose drejtori. Në raste emergjence dhe në mungesë të të parëve thirret edhe nga eksperti kontabël apo një person i caktuar nga gjykata me kërkesën e aksionerëve që zotërojnë jo më pak se 10% të aksioneve. Edhe për këto raste vendimi merret sipas kushteve të përcaktuara në pikën 3. Çdo vendim tjetër është i paligjshëm.

5. Për probleme të rëndësishme të karakterit emergjent apo operativ, ku mund të bëjnë pjesë edhe probleme që me ligj i janë caktuar për zgjidhje Asamblesë së Jashtëzakonshme, mund të vendosë Asambleja e aksionerëve ku përfaqësohen të paktën 2/3 e kapitalit themeltar dhe me miratim të të paktën 1/2 e votave.

Neni 12 shfuqizohet dhe zëvendësohet me:

Neni 12
Drejtori i përgjithshëm

1. Drejtori emërohet nga këshilli mbikqyrës kur janë dakord të paktën 2/3 e antarëve. A propozohet nga aksionerë ose grupe aksionerësh që zotërojnë të paktën 25% të aksioneve, s dhe nga antarët e këshillit mbikqyrës. Propozimi bëhet me shkrim. Ai duhet të jetë i nënshkruar nga të gjithë propozuesit dhe arshivohet bashkë me të dhënat mbi kapitalin që ata përfaqësojnë. Propozimet që s'i plotësojnë kushtet e mësipërme nuk mirren parasysh.

2. Nëse një antar i këshillit mbikqyrës emërohet drejtor, mandati i tij në këshill merr funksion me hyrjen e tij në funksion.

3. Drejtori emërohet për një periudhë 4 vjeçare dhe riemërohet automatikisht po për ac vjet nëse këshilli mbikqyrës nuk e shkarkon nga detyra apo ai vetë nuk jep dorëheqjen. Në rastet e mungesave për arsyet e përligjura por që zgjasin shumë dhe mund të rrezikojnë interesat e shoqërisë, këshilli mbikqyrës, me propozim të drejtorit emëron një zëvendës të përkohshëm të tij, i cili mund të jetë edhe antar i këshillit, por ky për një periudhë jo më të gjatë se 3 muaj.

4. Shpërblimi i drejtorit caktohet nga këshilli mbikqyrës në aktin e emërimit të tij.

5. Shkarkimi i drejtorit brenda afatit mund të bëhet vetëm për shkelje të rënda të detyrës e të interesave të shoqërisë. Propozimi mund të bëhet nga aksionerët apo grupi i aksionerëve që e kanë propozuar nga aksionerë të tjerë që përfaqësojnë të paktën 25% të kapitalit themeltar nga këshilli mbikqyrës dhe eksperti kontabël. Propozimi paraqitet për shqyrtim në asamblenë ku përfaqësohet të paktën 1/2 e kapitalit themeltar dhe miratohet me shumicë votash. Vendimi për shkarkimin ose jo të tij merret nga këshilli mbikqyrës dhe zbatohet sipas procedurës përkatëse.

6. Në rast fatkeqësie, shkarkimi apo dorëheqjeje, zëvendësimi i drejtorit bëhet brenda 3 muajsh, duke ndjekur procedurën e rregullt.

Neni 13 shfuqizohet dhe zëvendësohet me:

30. 01. 1997

Neni 13
Kompetencat e drejtorit

1. Drejtori ka kompetenca të plota ndaj të tretëve për të vepruar në emër të shoqërisë në çfarëdo rrethane, me përjashtim të kompetencave që i janë caktuar shprehimisht këshillit mbikqyrës nga ligji dhe nga ky statut.

Në marrëdhëniet me të tretët shoqëria merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga aktet e drejtorit edhe kur këto akte nuk përfshihen në objektin e shoqërisë, përveç rastit kur shoqëria provon se të tretët e dinin që akti i drejtorit kapërcente objektin e shoqërisë dhe vepronte me keqbesim, ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt, duke pasur parasysh faktin se vetë shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Kufizimet e kompetencave të drejtorit të caktuara në statut duhet të respektohen nga të tretët.

Megjithatë, në cilësinë e masave të rregullimeve të brendshme të shoqërisë, por që nuk u kundërvihen të tretëve, veprimet dhe masat e mëposhtme kryhen vetëm me autorizim të këshillit mbikqyrës.

- përcaktimi dhe ndryshimi i programit të veprimtarisë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë të shoqërisë.

- kryerja e investimeve dhe financimeve për vitin financiar si dhe masat e tjera që do të kërkonin ndryshime të rëndësishme në kapitalin dhe të ardhurat e shoqërisë.

- hapja e veprimtarive ose e njësisive të reja, shkrirje ose bashkimi dhe mbyllja tërësisht apo pjesërisht e veprimtarive dhe njësisive të shoqërisë.

- blerja, shkëmbimi dhe shitja e pasurisë që përbën aktivin e qëndrueshëm të shoqërisë, në rast se këto veprime e kalojnë masën 10% të të ardhurave të vitit paraardhës, por jo më shumë se dy herë në vit.

- themelimi i shoqërive ose pjesëmarrja në shoqëri të tjera të krijuara, ose për t'u krijuar.

- marrja e huave afatmesme, afatgjata, dhënia e dorëzanive ose e garancive të tjera kur këto të fundit tejkalojnë veprimtarinë e zakonshme të shoqërisë.

- përcaktimi i kriterëve për diskutimin, përfundimin dhe ndryshimin e kontratës së punës.

- në përgjithësi marrja e vendimeve dhe masave që e kapërcejnë veprimtarinë e zakonshme të shoqërisë dhe janë të tilla që mund të sjellin ndryshime në objektin e saj.

II. Drejtoria mund të delegojë një pjesë të kompetencave të tij, që ai i gjykon të dobishme, tek një ose disa persona të tjera që kryejnë funksione teknike në drejtimin e shoqërisë.

III. Drejtoria përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretët.

Emërtimi dhe pushimi i tij duhet të publikohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Aktet, me të cilat shoqëria merr përsipër detyrimet ndaj të tretëve, duhet të mbajnë nënshkrimin e drejtorit, ose të personit të autorizuar rregullisht nga drejtoria për këto akte, të shoqëruar nga vula e shoqërisë.

Është e detyrueshme që çdo marrëdhënie ndërmjet drejtorit dhe këshillit mbikqyrës të regjistrohet ose të pasqyrohet në procesverbal.

Marëdhëniet midis shoqërive përcaktohen me rregullore të veçantë të cilat miratohen nga këshillat mbikqyrës të këtyre shoqërive.

Neni 14 shfuqizohet dhe zëvendësohet me:

Neni 14
Marrëveshjet ndërmjet shoqërisë dhe drejtorit
ose antarëve të këshillit mbikqyrës

Çdo marrëveshje ndërmjet shoqërisë dhe drejtorit ose një anëtari të këshillit mbikqyrës, qoftë e drejtpërdrejtë ose jo e drejtpërdrejtë, duhet t'i nënshtrohet autorizimit paraprak të këshillit mbikqyrës.

Kjo dispozitë është e zbatueshme edhe për marrëveshjet ndërmjet shoqërisë dhe një shoqërie tjetër, kur njeri nga anëtarët e këshillit mbikqyrës është edhe anëtar i këshillit mbikqyrës të shoqërisë tjetër, me të cilën propozohet të lidhet marrëveshja.

Dispozitat e mësipërme nuk janë të zbatueshme për marrëveshjet që kanë të bëjnë me veprimet rrjedhëse të shoqërisë që kryhen në kushtet normale.

Drejtori ose anëtari mbikqyrës i interesuar duhet të njoftojë këshillin mbikqyrës sapo merr dijeni për një marrëveshje, për të cilën zbatohen kërkesat e këtij neni të statutit. Anëtari i këshillit mbikqyrës i interesuar nuk merr pjesë në votimin për dhënien e autorizimit.

Neni 15 shfuqizohet dhe zëvendësohet me:

30. 01. 1997

Neni 15
Eksperti kontabël i autorizuar

Kontrolli financiar i veprimtarisë së shoqërisë bëhet nga një ekspert kontabël i autorizuar, që emërohet nga këshilli mbikqyrës dhe kryen misionin e vet në pajtim me ligjin. Ai emërohet për një vit financiar dhe emërimi përsëritet automatikisht nëqoftëse këshilli mbikqyrës nuk e shkarkon nga detyra ose nuk emëron një tjetër. Kompetencat e tij rregullohen sipas ligjit.

Neni 16 shfuqizohet dhe zëvendësohet me:

Neni 16
Ushtrimi financiar

Ushtrimi financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor të çdo viti.

Neni 17 shfuqizohet dhe zëvendësohet me:

Neni 17
Inventari- llogaritë vjetore

Shoqëria do të mbajë një kontabilitet të rregullt të pasurisë dhe të veprimtarisë së saj, në pajtim me kërkesat ligjore.

Në mbyllje të ushtrimit, drejtoria harton inventarin e pasurisë në këtë datë dhe llogaritë vjetore për ushtrimin financiar.

Drejtori përgatit gjithashtu edhe raportin e administrimit për gjendjen e shoqërisë gjatë ushtrimit financiar të kaluar, ndryshimet e parashikuara për të ardhmen, ngjarjet më të rëndësishme që kanë ndodhur gjatë periudhës nga data e mbylljes të ushtrimit financiar deri në datën e hartimit të këtij raporti, si dhe veprimtaritë në fushën kërkimore-shkencore.

Neni 18 shfuqizohet dhe zëvendësohet me:

Neni 18
Rezultati i ushtrimit dhe caktimi i fitimeve

Rezultati i ushtrimit përcaktohet si diferenca ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të ushtrimit, duke përfshirë të këto të fundit amortizimet dhe provizionet.

Nga fitimet e ushtrimit, të pakësuara kur është rasti, me humbjet e mëparshme, hiqet të paktën 20% për të krijuar rezervën e domosdoshme.

Heqja nga fitimet për rezervën e domosdoshme pushon së qeni e detyrueshme kur jo rezervë arrin 1/10 e kapitalit themeltar. Ajo rifillon kur për një arsye çfarëdo rezerva e domosdoshme ka zbritur nën 1/10 e kapitalit themeltar.

Nga fitimet e ushtrimit të pakësuar, kur është rasti, me humbjet e mëparshme, shoqëria do të heqë jo më shumë se 85% për krijimin e rezervave për zhvillim.

Shuma e fitimeve të mbetura pas veprimeve të përmendura më sipër dhe detyrimeve ligjore ndaj shtetit a të tretëve përfaqëson **dividentin** (fitimin neto të ndashëm), i cili do të ndahet midis aksionerëve në raport me kapitalin që ata përfaqësojnë.

Duke përjashtuar rastin kur është vendosur zvogëlimi i kapitalit, nga fitimet e ushtrimit nuk bëhet asnjë heqje dhe asnjë derdhje dividenti, në qoftë se kapitalet disponues janë ose do të bëheshin më të vogla se shuma e kapitalit themeltar plus shumën minimale të kërkuar për rezervën e domosdoshme.

Në qoftë se ekziston një humbje, kjo mbartet për t'u përfshirë në fitimet e ushtrimit të ardhshëm deri në shuarjen e saj.

Neni 19 shfuqizohet dhe zëvendësohet me:

Neni 19
Shkarkimi i drejtorit paraardhës

30. 01. 1997

Drejtori i mëparshëm dorëzon detyrën brenda 1 muaji nga data e zgjedhjes së drejtorit të ri, duke i kaluar këtij të gjithë dokumentacionin e shoqërisë dhe informacionin e duhur. Drejtori ri jep llogari përpara shoqërisë vetëm për veprimet e kryera nga ai pas marrjes së detyrës në dorëzim.

Neni 20 shfuqizohet dhe zëvendësohet me:

Neni 20

Ushtrimi i parë financiar i shoqërisë aksionere "**Botimet enciklopedike**" fillon më datën 1 janar 1997. Periudha nga regjistrimi në regjistrin tregtar deri në këtë datë do të përdoret kryesisht për bërjen e inventareve dhe mbylljen e ushtrimeve financiare të mëparshme.

Të gjitha vlerat materiale të trashëguara nga ushtrimi i mëparshëm i SHA "**Shtëpia botuese enciklopedike**" që nuk bënin pjesë në kapitalin themeltar dhe për pasojë nuk i janë nënshtruar shitjes në ankand, do të administrohen me po atë rregull si vlerat që do të krijohen gjatë ushtrimit të SHA "**Botimet enciklopedike**". Të ardhurat e siguruara nga shitja e tyre e mundshme nuk do të llogariten në nxjerrjen e dividendit vjetor, por do të përdoren për modernizimin e ndërtesës dhe të pajisjeve të punës ose do të kalojnë si zë i veçantë në rezervën për zhvillim.

Shtohet neni 21:

Neni 21

Për të gjitha ato çështje procedurale apo të tjera, për të cilat nuk është shprehur në këtë statut, do të vepronet sipas ligjeve përkatëse në fuqi.

Kryetari i Asamblesë

Arben Xoxa



V E R T E T O H E T

SHA BOTIMET
ENCIKLOPEDIKE
TIRANE

Sekretaria

Ermira Shpëtimi

Tiranë, më 7.12.1996